



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 14.12.2018

Në mbështetje të Nenit 53, paragrafit 3, dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe nbdryshuar me Ligjin nr.03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Paragrafi 1.4 të rregullores Nr. 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Nenit 8 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Thirrjes Publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë si dhe vendimit Nr. 800, dt. 22.11.2018 dhe vendimit Nr. 800/1 të datës 23.11.2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e vendimit Nr.800 të datës 22.11.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së për Themelimin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të pranuar nga OJQ-të për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve, Komisioni vlerësues nxjerrë këtë:

V E N D I M

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara në vendimin e lartëpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike të datës 02 Nëntor 2018, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve Komisioni vlerësues ka shpallur fituesit për objektivat:

- **2.1. Promovimi i Zhvillimit Socio - Ekonomik Rajonal të Balancuar:** janë përzgjedhur gjashtë (6) projekt-propozime për financim: *Instituti për Studime të Avancuara 2M*, *Agjencia Zhvillimore Rajonale - AZHR Perëndim*, *Agjencia Zhvillimore Rajonale - AZHR Jug*, *Agjencia Zhvillimore Rajonale - AZHR Qendër*, *Agjencia Zhvillimore Rajonale -AZHR Veri*, *Agjencia Zhvillimore Rajonale - AZHR Lindje*;
- **2.2. Nxitja e rrjetëzimeve me qellim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal:** janë përzgjedhur katër (4) projekt-propozime për financim: *OJQ "Penna"*, *OJQ "Organizata Studentore e Fushë Kosovës"*, *OJQ "Royal"*, *OJQ "Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës"*;
- **2.3. Nxitja dhe vetëdijesimi i të rinjve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik:** është përzgjedhur një (1) projekt-propozim për financim: *OJQ "Iniciativa për Zhvillim të Qëndrueshëm - IZHQ"*;

ARSYETIM

Komisioni brenda afatit të përcaktuar me Planin e veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni. Në fazën e parë në bazë të kriterëve formale nga dyzet e katër (44) aplikacione, kriteret formale i kanë plotësuar njëzet e tre (23) prej tyre. Fazës së dytë të vlerësimit i janë nënshtruar njëzet e tre (23) OJQ, sipas kriterëve të Thirrjes Publike, ku Komisioni ka vlerësuar se dymbëdhjetë (12) nga këto OJQ nuk i plotësojnë kriteret e fazës së dytë (vlerësimit përmbajtësor) për të fituar financimin nga MZHR.

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuara me planin e punës të miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, duke vlerësuar secilin projekt-propozim veç e veç sipas Thirrjes Publike të datës 02 Nëntor 2018.

Komisioni ka patur parasysh Rregulloren mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, rregullat e punës si aneks i kësaj rregulloreje dhe Thirrjen Publike nga MZHR të datës 02 Nëntor 2018.

Afati i OJQ-ve për aplikim për dorëzimin e projekt-propozimeve ishte nga data 02 Nëntor 2018 deri më 22 Nëntor 2018.

Sipas Thirrjes Publike, kriteret e përcaktuara ishin të ndara në ato të përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

Për të qenë e pranueshme për këtë thirrje organizata aplikuese duhet të:

- Jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare.
- Jetë e pajisur me numër fiskal – të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovë.
- Ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit.
- Ketë përvojë dhe veprimtari në fushën e qeverisjes lokale.
- Ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme.
- Mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyruesh apo likuidimit.
- Mos ketë shkelur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike.
- Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin akitivitet gjatë këtij viti. Prandaj me rastin e aplikimit kërkohet deklarata për shmangjen e financimit të dyfishtë;
- Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit.

Gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të këtyre kriterëve, Komisioni vlerësues u pajtua që njëzetë e një (21) projekt-propozime të diskualifikohen kurse njëzetë e tre (23) të tjera të kualifikohen për fazën e dytë të vlerësimit.

Kriteret e veçanta:

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësoj edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzoj brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike.
- Të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes.
- Të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme.
- Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/ programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse.
- Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

Nga kjo, Komisioni ka konstatuar se nga gjithsejtë njëzetë e tre (23) projekt-propozime të OJQ-ve që i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe rrjedhimisht kanë kaluar në fazën e dytë të vlerësimit, njëmbëdhjetë (11) prej tyre i plotësojnë edhe kriteret e veçanta për t'u kualifikuar si përfituese të financimit nga MZHR kurse dymbëdhjetë (12) të tjera diskualifikohen.

Shuma totale e ndarjes së buxhetit për financimin e njëmbëdhjetë (11) projekt-propozimeve të përzgjedhura është: 64,680.00€ (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë Euro).

Komisioni i vlerësimit të projekt-propozimeve të OJQ-ve;


Blerim Hasani, Kryesues

Sanel Muric, Anëtar

Arbnor Sadiku, Anëtar

Pranvera Muçaj, Anëtare

Valmira Shatri, Anëtare

The block contains five horizontal lines, each with a handwritten signature in blue ink. The signatures are: 1. Blerim Hasani (Kryesues), 2. Sanel Muric (Anëtar), 3. Arbnor Sadiku (Anëtar), 4. Pranvera Muçaj (Anëtare), and 5. Valmira Shatri (Anëtare).